



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, nenit 5 pika 1.paragrafi 1.3, nenit 6 paragrafi 3, nenit 13, nenit 21 paragrafi 5 dhe 6 dhe nenit 22 të Rregullores QRK NR.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 28.01.2025, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZONËN KADASTRALE BABUSH I MUHAXHERËVE

Neni 1

MIRATOHET oferta e përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë:

1.NIKA PRO-ING SH.P.K me Numër Unik Identifikues 811052307 me adresë: Rruga "Rexhep Bislimi" p.n Ferizaj, me pronar Shpend Musa, shfrytëzues i pronës të paluajtshme të komunës në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve.

2.Prona e paluajtshme e komunës gjendet në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve, e përshkruar në evidencen kadastrale përkatëse, si në tabelën në vijim:

Nr.	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Sipërfaqe për shfrytëzim m ²
1.	Komuna Lipjan	P-71409059-00559- 11	Babush i Muhaxherëve	10000

3. Shfrytëzimi afatgjatë i pronës komunale prej 99 vitesh do të jetë pa kompensim nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

4. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës të palujatshme të komunës, siç përcaktohet në nenin 1 pika 2 e këtij vendimi, destinohet kryesisht për: **Fabrikë për riciklimin e qelqit**, ku vlera investive është në shumën prej 4,766,700.00 €, ndërsa numri i të punësuarve nga ky investim do të jetë 78 punëtor nga Komuna e Lipjanit, sipas konceptit të përgjithshëm të projektit NIKA PRO-ING Sh.P.K, Ferizaj datë 10.10.2024.

Neni 2

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme në ZK- Babush i Muhaxherëve.

Neni 3

Pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet titullarit të pronës- Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Zyra e Kryetarit-Sektori Pronëso- Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati i Inspektionit, Drejtorati i Infrastrukturës dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 15-462/01-4919

Lipjan, më 28.01. 2025

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

